



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Për :	N.P.Sh. "El-Ing"
Nga:	Operatoret Ekonomik Egronit Gaxherri – UD. Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës
Data:	26.06.2025

(autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores A002 nr. 002/2024 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik N.P.Sh. "El-Ing" të datës 20.06.2025 kundër NJOFTIMIT MBI VENDIM TË AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 636-25-3770-2-2-1, Komuna e Junikut (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. **APROVOHET SI E BAZUAR** kërkesa për rishqyrtim të operatorit ekonomik " N.P.Sh. "El-Ing" të datës 20.06.2025, kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit **636-25-3770-2-2-1**.
- II. **ANULOHET** njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, i publikuar me datën 19.06.2025.
- III. **Autoriteti Kontraktues**, vendos që ta kthejë lënden në ri-vlerësim.
- IV. **NJOFTOHEN** të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



### Arsyetim

Operatori Ekonomik N.P.Sh. "El-Ing" (tutje "parashtruesi") me datë 20.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull " Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit **636-25-3770-2-2-1**.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendim nr. 1:** "Kërkesa 7 e dosjes së tenderit, 'Stafi i nevojshëm', ka kërkuar nga Operatori Ekonomik të ofrojë dëshmi për një staf minimal prej 5 punëtorësh të angazhuar në projekt, nëpërmjet një liste tabelare të personelit, të nënshkruar dhe të vulosur. Autoriteti Kontraktues (AK) ka eliminuar OE N.P.Sh. 'El-Ing' me arsyetimin se kjo kërkesë nuk është përmbushur. Ne pretendojmë se kemi ngarkuar dhe dorëzuar dokumentin 'Lista e punëtorëve të cilët do të angazhohen në projekt, i cili përfshin listën tabelare me 5 punëtorë (Denis Iberhysaj, Eduard Smajli, Eron Muriqi, Veton Sejdiq, Rame Lajqi), me pozicionin, statusin dhe numrin personal të tyre, siç kërkohet, dhe dokumenti është i vulosur dhe i nënshkruar nga kompania jonë. Rrjedhimisht, eliminimi ynë në këtë bazë është i pabazuar, pasi dokumentacioni është ofruar dhe AK duhet të kishte kërkuar sqarime sipas Nenit 72 të LPP-së në rast paqartësie, në vend të eliminimit direkt, duke cenuar parimin e barazisë në trajtim siç specifikohet në Nenin 7 të LPP-së."

**Përgjigja:** Pretendimi i Operatorit Ekonomik N.P.Sh. 'El-Ing' lidhur me Kërkesën 7 është pjesërisht i bazuar.

**Pretendim nr. 2:** "Kërkesa 8 e dosjes së tenderit, 'Pajisjet teknike të nevojshme', kërkonte nga Operatori Ekonomik të posedojë dhe të dëshmojë me kopje të librezave të pronësisë, DUD-it doganor, faturave të blerjes, ose kontratave të qiramarrjes, për: minimumi një autoshport për ngritje në lartësi dhe minimumi një kamion me mekanizëm të veçantë (vinç) për ngritje të shtyllave. Autoriteti Kontraktues (AK) ka eliminuar OE N.P.Sh. 'El-Ing' me arsyetimin se kjo kërkesë nuk është përmbushur. Ne pretendojmë se kemi ngarkuar dhe dorëzuar dokumentacionin e plotë: për autoshportin kemi ofruar 'Lista paisjeve-El-Ing.pdf' ku figuron 'Kamion me korpë' dhe dëshmi posedimi përmes 'Paisje-El Ing.pdf'. Për kamionin me mekanizëm (vinç), kemi siguruar një



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY JUNIK

---

'Kontrate Mbi Qirane.pdf' e cila vërteton qiramarrjen e një 'Kamion kiper me kran' (me targat 03-258-GB) për projektin specifik, si dhe 'IVECO 03-258-GB KIPER ME KRAN.pdf' që është certifikata e regjistrimit të këtij mjeti. Përdorimi i kontratës së qiramarrjes është një formë e pranueshme e dëshmisë sipas vetë dosjes së tenderit. Rrjedhimisht, eliminimi ynë në këtë pikë është i padrejtë dhe në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, pasi kemi përmbushur kërkesat e parapara."

**Përgjigja:** Pretendimi i Operatorit Ekonomik N.P.Sh. 'El-Ing' lidhur me Kërkesën 8 është i bazuar.

Pretendimet e juaja janë të bazuara, prandaj Autoriteti Kontraktues do ta kthejë lënden në ri-vlerësim.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.